


# KUSH JEMI NE?


Duke  
udhëhequr ne i  
mundësojmë vetes dhe të tjerëve  
të ardhme të ndritur dhe mundësi të  
barabarta!



NE JEMI  
KOKA DHE DUART  
E  
SHTETIT TONË

# MËNYRA IDEALE E QEVERISJES

FAZE (15), ALBESA (15), FESTIM (14), ERNIS, (14)



**Nëse keni pasur gjithmonë dëshirë të mësoni për demokracinë, mirëpo nuk keni ditur ku t'i gjeni këto informata, atëherë ne do të përpiqemi që t'iu tregojmë sa më shumë gjëra për këtë temë. Na lexoni artikullin tonë!**

Përshëndetje, për juve lexues. Ne sot në organizatën TOKA kemi diskutuar shumë gjatë për disa tema shumë të rëndësishme. Pas diskutimit, u ndamë në dy grupe të vogla. Njëri nga ta, jemi ne, grupi i cili do të flas për demokracinë. Ne gjithashtu kemi dy anëtarë të grupit, të cilët kanë vizatuar punimet që po i shihni në artikullin tonë. Por, çfarë është demokracia? Nëse keni dëshirë të mësoni për demokracinë dhe rolin e saj, atëherë vazhdoni leximin.

Sipas nesh, demokracia është formë e qeverisjes, në të cilën udhëheq populli përmes votës së lirë. Fjala demokraci rrjedh nga fjalët greke „demos“ që do të thotë popull dhe „kratos“ që do të thotë qeverisje ose pushtet. Kjo do të thotë se ne gëzojmë pushtetin.

Format më të përhapura të demokracisë janë: demokracia e drejtpërdrejtë dhe ajo përfaqësuese. Demokracia e drejtpërdrejtë ka lindur në kryeqytetin e Greqisë, që është Athina. Në atë kohë të drejtë pjesëmarrje në vendimet shtetërore kanë pasur vetëm burrat e pasur. E këtë të drejtë nuk e kishin të varfërit, personat nën moshën 18 vjeçare, apo personat e mosshuar. Kjo sipas mendimit tonë nuk ishte forma më e mirë e prezantimit të demokracisë. Forma ideale e qeverisjes, për ne, është demokracia përfaqësuese.

Ne mendojmë kështu, sepse në këtë formë të qeverisjes, të gjithë ne, qytetarët e një vendi, trajtoheni në mënyrë të barabartë. Kjo për neve është gjëja më e rëndësishme në jetën tonë. Kur trajtoheni në mënyrë të barabartë ne ndihemi të lumtur, shkolloheni ashtu si duhet, jetojmë në paqe dhe liri, kemi mundësi të barabarta për t'iu zhvilluar dhe zëri ynë dëgjohet gjithmonë.

Ne kemi një shembull për të treguar se si të gjithë trajtoheni në mënyrë të barabartë si në rastin e shpërtimeve, ashtu edhe në dënime. Ishim në shkollë. Në oborr të shkollës kemi disa lule shumë të bukura. Duke luajtur, pa dashje kemi shkelur në to. Pasi që të gjithë e shkaktuam dëmin, të gjithë u dënuam në mënyrë të barabartë. Demokracia ka elementet si liria, respekti, barazia dhe paqja. Ne mendojmë se këto janë elemente në bazë të të cilave ne duhet të jetojmë jetën tonë. Faleminderit për vëmendjen tuaj!



Gazetarët më të mirë shkruajnë për demokracinë

## SISTEM I VLERËS

ELVIS (14), ELIZA (15), ENEIDA (14), EDUARD (14), DIONIS (15), ARDIAN (14), ARLIND (16)


**Çdo gjë funksionon siç është më miri, atëherë kur gjërat definohen. E se si funksionon shteti kur ndahet fuqia, apo thënë më mirë pushteti, mund të mësoni në artikullin në vazhdim**

Derisa Eneida dhe Elvisi ishin duke diskutuar rreth pyetjes që edukatorja na parashtroi, e cila ishte: „Si lidhet Ndarja e Pushtetit me demokracinë?“, shoku Ardian veçse e kishte një përgjigje. Demokracia është sistem i qeverisjes ku të gjithë qytetarët ndihen të lirë të ushtrorjnë në mënyrë të pavarur atë që e duan. Këtu mund ta bëjmë një ndërlidhje mes Ndarjes së Pushtetit dhe demokracisë. Ndarja e Pushtetit synon funksionim të pavarur të institucioneve. Po ashtu, mundëson që secili prej tyre t'iu përgjigjet detyrave të veta e jo një institucion të jetë mbi institucionet e tjera.

Në Kosovë, pushteti ndahet në tri degë: legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor. Për pushtetin legjislativ do të mësoni në artikullin e grupit tjetër, në faqen e radhës.




Autorët e artikullit



Pushteti Ekzekutiv, Qeveria

Pushteti Gjyqësor ushtrorhet nga Gjykata. Ky pushtet ka për qëllim që ligjet e miratuara të zbatohen dhe të kenë rëndësinë e njëjtë tek të gjithë qytetarët, pa dallime. Në këtë mënyrë, arrihet edhe barazia në njëri anë, por edhe funksionimi i drejtë i shtetit. Si është e mundur të arrihet barazia në këtë mënyrë, mund të pyes ndonjëri prej lexuesve? Nëse dy apo më shumë qytetarë kanë vepruar në kundërshtim me ligjin, atëherë të gjithë ata duhet të dënohen në mënyrë të njëjtë, e jo dikush të dënohet e dikush tjetër jo. Para ligjit nuk duhet të ketë dallime. Duke vepruar në këtë mënyrë, evitohet pabarazia dhe qytetarët vetëdijësohen për gabimet e tyre. Këtë e siguron gjykata.

Pushteti Ekzekutiv ka rëndësi ashtu si ai legjislativ apo gjyqësor. Po të mos ishte ky pushtet, pa dyshim që gjërat do të ishin shumë më ndryshe. Kur themi kështu mendojmë për ligjet, të cilat miratohen në Kuvend. Këto ligje qëllim kanë përmirësimin e jetës së qytetarëve në komunitetin e tyre. Është Qeveria ai institucion i cili i zbaton këto ligje, dhe në mungesë të tij mund të paramendoni edhe ju të dashur lexues, se shumë gjëra nuk do të ishin ashtu siç janë sot. Miratimi dhe zbatimi i ligjeve nga një institucion i vetëm nuk do të ishte shumë produktiv. Do të ishte njëjtë sikur në grupin tonë, edukatorja të na tregonte për temën dhe të shkruante të tërë artikullin vetëm. Ky ndoshta nuk është krahasimi më i mirë i mundshëm, por me të mbase e keni kuptuar më mirë këtë temë komplekse.



Drejtësia vendoset prej gjykatës



## KUVENDI MË PËRFAQËSON DENJËSISHT


ROVENA (14), KRISTIAN (14), LEON (15), KAJTAZ (15), EDUARTA (14), FLAMUR (15), ATDHE (14)



### Kosova ka demokraci me sistem parlamentar, që nënkupton se populli zgjedh personat më të mirë të vendit për të na përfaqësuar denjësisht

Shteti ynë Kosova që nga viti 2008 zyrtarisht është shtet i pavarur dhe demokratik. Pikërisht, sistemi demokratik është ai që na ka dhënë lirinë që të zgjedhim personat që ne duam. Andaj, populli ynë me shumë kujdes dhe përkushtim zgjedh çdo herë deputetët si përfaqësues të duhur të popullit. Këta përfaqësues

situacioneve shtetërore, ne ndihemi të sigurtë në shtetin ku jetojmë. Se Kuvendi mendon vazhdimisht për të ardhmen tonë, vërehet edhe nga vetë pjesëmarrja jonë në projektin „Demos-ti“. Këtu kemi mundësi të marrim njohuri dhe ta shohim për nga afër punën e pandalshme që Kuvendi bën për ne. Roli dhe rëndësia e Kuvendit fillon qysh nga miratimi i ligjeve, të cilat garantojnë trajtim të barabartë për të gjithë pa asnjë dallim, e deri tek çështjet si ndotja e ajrit apo hedhja e mbeturinave. Për fund, duam ta citojmë një thënie që shumë shpesh e dëgjojmë e që tregon shumë për rëndësinë e popullit për të zgjedhur deputetët. Kjo thënie është: „populli i mirë zgjedh deputetët e mirë.“ Andaj le të tregohemi të mirë dhe ta ndihmojmë zhvillimin e shtetit tonë. Nëse ne nuk mendojmë për të mirën e shtetit tonë, kush mund ta bëjë këtë për ne? Të gjithë së bashku për një demokraci të mirëfilltë dhe qeverisje të dinjitetshme.



Ti vendos, sepse ke fuqi për të bërë ndryshim

nuk janë vetëm nga komuniteti shumicë, por përfshihe edhe qytetarë nga komunitetet jo shumicë. Kjo automatikisht nënkupton se Kuvendi promovon edhe barazinë ndër-etnike. Vlen të theksohet se Kuvendi është i vetmi institucion ligjvënës në Republikën e Kosovës. Ky fakt i jep pushtetin që tashmë e gëzon. Ndër të tjera, Kuvendi zgjedh Presidentin, Qeverinë dhe Kryetarin e Kuvendit. Falë punës së pandalur të këtyre in-



Jemi gazetarë të zellshëm dhe shumë punëtorë

## MEDIA DHE LLOJET E SAJ

ERVISA (15), EGZONA (14), MIRLIND (15), SUADA (15)

**Ne sot jemi bërë gazetarë dhe do t'iu informojmë për median dhe llojet e saj. Për më shumë gjëra lidhur me këtë temë, lexojeni artikullin e përgatitur më poshtë**

Është ditë e shtunë. Unë jam në shtëpinë time dhe javën e kaluar kam mbushur 18 vjet. Nesër do të mbahen zgjedhjet dhe kjo është hera e parë që unë do të votoj. Por, fatkeqësisht nuk jam shumë e informuar për kandidatët e mundshëm. Për këtë kam nevojë që të marrë më shumë informata.

Tani jam para televizorit dhe kam blerë shumë gazeta për shkak se dua të di se për cilin kandidat të votojë. Në orën 7 do të fillojë edicioni i lajmeve dhe unë do të kem mundësi të njoftohem me kandidatët dhe planet e tyre për të ardhmen e shtetit. Kështu duke u bazuar në këto informata, kur të nesërmen të shkojë në vend votim unë e di se cilit/es kandidat/e do t'ia jap votën time të vlefshme. Kjo duke iu falenderuar medias.

Media shërben për të na dhënë informata të ndryshme.

Llojet e medias janë: gazeta, radio, TV, librat, telefoni, fotografitë, rrjetet sociale, posta, interneti, etj.

Media ndahet në dy grupe, në të shkruara dhe elektronike. Media e shkruara janë: gazetata, librat, posta, revista, etj. Ndërsa, media elektronike janë: radio, TV, telefoni, interneti, fotografitë, rrjetet sociale dhe posta elektronike. Informatat nga media duhet të jenë: të sakta, të vërteta, objektive, të paanshme dhe duhet të jenë të vërtetuara nga shumë burime.

Përmes tyre mund të informohemi për zgjedhjet, ashtu si përmendëm më lart; mund të informohemi për gjërat që ndodhin nëpër botë, për ndonjë fatkeqësi natyrore, për ndonjë produkt të ri, për ndonjë shkollë e cila sapo është hapur, etj. Shpresojmë që edhe ne kemi arritur t'iu informojmë në mënyrën e duhur.




Unë duke u njoftuar për kandidatët më të mirë



Media jeni ju. Media jemi ne!



Sot, edhe unë po punoj të bëj një gazetë të tillë



Zërat tanë dëgjoen fuqishëm





## IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI  
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA  
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



**ERSTE Stiftung**

Redaktohet nga  
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit  
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga  
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:  
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Motrat Qiriazit“  
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: IX-2  
Website: www.demos-ti.org Vendi: Klinë

